



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 66

Tiranë – E mërkurë, 8 maj 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 27.2.2019	Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në mbështetje të projekteve investuese në turizëm..... 5011
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 4.4.2019	Për shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.2.2018, “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike” dhe nr. 172, datë 27.2.2019, “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në mbështetje të projekteve investuese në turizëm”..... 5012
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 26, datë 22.2.2019	Për miratimin e rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”..... 5012
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 64, datë 15.4.2019	Për miratimin e rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” 5015
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 368, datë 2.5.2019	Për delegim kompetence..... 5017
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 15.4.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve”..... 5018

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 15.4.2019	Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Furnizuesit.....	5020
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 15.4.2019	Për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi totale të instaluar 1125 kw.....	5022
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 60, datë 15.4.2019	Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., prej 28 lekë/m ³ ose 2.6457 lekë/kwh, deri më datë 31.12.2019.....	5024
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6551, datë 2.5.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një akti ndërkombëtar.....	5025
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Astrit Puci.....	5026
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasës Lidia Preka.....	5026

**VENDIM****Nr. 172, datë 27.2.2019****PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË
PROCEDURAVE TË KALIMIT NË
PRONËSI TË PËRFITUESVE TË TOKËS
BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE
BUJQËSORE, NË ZONAT ME
PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT,
NË MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE
INVESTUESE NË TURIZËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pezullimin e përkohshëm të vijimit të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në mbështetje të projekteve investuese në turizëm, sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi, publikuar edhe në Gjeoportalin Kombëtar, të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), deri në kalimin/regjistrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore, në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi.

2. Harta bashkëlidhur këtij vendimi përfshin pasuritë e paluajtshme, të evidentuara në zonat kadastrale, të miratuara me vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 707, datë 21.11.2018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare

Shkodër–Fier” dhe nr. 708, datë 21.11.2018, “Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë–Sarandë”.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, territori administrativ i të cilave përfshihet në hartën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të pezullojnë procedurat e kalimit në pronësi të tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, pavarësisht nga faza procedurale, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol për vijimin e procedurave të regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, bazuar në hartën bashkëlidhur këtij vendimi. Pasuritë e paluajtshme, që ndodhen në zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, regjistrohen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit fillestar.

5. Vendimi nr. 138, datë 23.2.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 241, datë 4.4.2019**

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NR. 138, DATË 23.2.2018, “PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË PROCEDURAVE TË KALIMIT NË PRONËSI TË PËRFITUESVE TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE DHE TË REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI, NË ZONËN ME RËNDËSI PËR FONDIN E MBËSHTETJES SË INVESTIMEVE STRATEGJIKE” DHE NR. 172, DATË 27.2.2019, “PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË PROCEDURAVE TË KALIMIT NË PRONËSI TË PËRFITUESVE TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH-NDËRMARRJEVE BUJQËSORE, NË ZONAT ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT, NË MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE INVESTUESE NË TURIZËM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 138, datë 23.2.2018, “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e

mbështetjes së investimeve strategjike” dhe nr. 172, datë 27.2.2019, “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në mbështetje të projekteve investuese në turizëm”, shfuqizohen.

2. Ngarkohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 26, datë 22.2.2019**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR VEPRIMTARITË JASHTË
FUNKSIONIT TË PROKURORËVE”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 164, pika 8 dhe nenin 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe draftin e rregullores,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, sipas draftit bashkëlidhur.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR**Gent Ibrahimi**



RREGULLORE
PËR VEPRIMTARITË JASHTË
FUNKSIONIT TË PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 143 të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 34, datë 10.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 189/1/c, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, hartohet dhe miratohet rregullorja si më poshtë:

Neni 1
Objekti

Ky akt përcakton rregulla të detajuara që lidhen me aktivitetin e prokurorit të shkruajë, të publikojë, të japë leksione dhe mësimdhënie për çështjet ligjore dhe të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me çështje ligjore, sistemin ligjor, administrimin e drejtësisë dhe çështje të tjera të lidhura me to (veprimtari jashtë funksionit) gjatë dhe jashtë orarit të punës dhe procedurën e pajisjes me autorizim nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 2
Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të krijojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për të siguruar rregulla të njëjta për prokurorët, duke garantuar parimin e barazisë dhe të proporcionalitetit.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë magjistratët prokurorë të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Parimet

Parimi i barazisë: çdo magjistrati prokuror i njihet e drejta të ushtrojë veprimtari jashtë funksionit.

Parimi i proporcionalitetit: e drejta për të ushtuar veprimtari jashtë funksionit, mund të kufizohet në rast se:

- bie ndesh me interesat thelbësore dhe me dinjitetin e ushtrimit të funksionit të prokurorit;
- cenohen afatet dhe ushtrimi në mënyrë eficiente i funksioneve;
- krijohen dukshëm perceptime të ndikimit ose njëanshmërisë gjatë ushtrimit të funksionit;
- bie ndesh me qëllimin për të cilin është ulur ngarkesa e punës;
- shpërblimi për veprimtari jashtë funksionit tejkalon rregullat e zakonshme të tregut.

Parimi i procesit të rregullt: në çdo rast dhënia e autorizimit i nënshtrohet një procesi të rregullt sipas një procedure të caktuar, në zbatim të parashikimeve të nenit 9, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 5
Kërkesa drejtuar Këshillit

1. Prokurori i cili është i interesuar të ushtrojë veprimtari jashtë funksionit paraqet kërkesë me shkrim pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e cila duhet të përmbajë minimalisht:

- a) emri dhe vendi i institucionit ku ai do të ushtrojë veprimtarinë jashtë funksionit;
- b) shpërblimin që do të përfitojë;
- c) kohëzgjatjen e kontratës;
- d) orët jashtë funksionit në një javë, gjatë dhe jashtë orarit të punës;
- e) pozicionin që do të mbajë (pedagog /asistent pedagog);

2. Kërkesës i bashkëngjiten vërtetimet nga drejtuesi për sa më poshtë;

- a) çështjet që prokurori ka në shqyrtim në momentin e paraqitjes së kërkesës;
- b) mesataren e ngarkesës në prokurorinë ku ushtron funksionin;
- c) përmbushja në kohë e detyrave gjatë 12 muajve të mëparshëm;
- d) “ulja në ngarkesë” në qoftë se prokurori ka përfituar dhe shkaqet për të cilat e ka përfituar.



Neni 6

Kushtet për të autorizuar veprimtarinë akademike

1. Ngarkesa e kërkuesit duhet të jetë jo më e lartë se mesatarja e ngarkesës së prokurorëve të prokurorisë ku ushtron funksionet.

2. Veprimtaria jashtë funksionit të mos ushtrohet më shumë se 2 orë në javë gjatë orarit të punës.

3. Në çdo rast, prokurori nuk mund të përfshihet në më shumë se 1 institucion të arsimit të lartë, në një semestër akademik.

4. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit, në asnjë rast nuk duhet të përbëjë shkak për shmangien e detyrimit për t'u paraqitur në seancë gjyqësore, në vendin e ngjarjes apo në çdo veprim të ngutshëm që nevojitet të kryhet për shkak të funksionit të prokurorit.

Neni 7

Përlllogaritja e pagës dhe përfitimeve

1. Masa e shpërblimit në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë vlerën, që duhet të marrë për të njëjtën veprimtari, për të njëjtat kushte dhe grada shkencore, një person që nuk është magjistrat.

2. Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale kur e çmon të nevojshme mund të bëjë hetim administrativ për të përlllogaritur pagën mesatare në treg për funksione të ngjashme në institucione të tjera akademike apo aktivitete trajnuese të së njëjtës natyrë.

Neni 8

Procedura e ndjekur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

1. Kërkesa e paraqitur nga prokurori së bashku me dokumentacionin shoqërues shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, brenda 5 (pesë) ditësh nga paraqitja.

2. Kryetari i Komisionit i cakton njërit prej anëtarëve shqyrtimin e dosjes dhe paraqitjen e një relacioni.

3. Nëse anëtari i komisionit i ngarkuar me shqyrtimin e dosjes e sheh të nevojshme, mund

të kërkojë dokumentacion shtesë, apo edhe të pyesë prokurorin i cili ka paraqitur kërkesën.

4. Brenda tri javëve nga paraqitja, kërkesa merret në shqyrtim nga Këshilli në seancë plenare.

5. Çështja relatohet nga anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, i cili ka shqyrtuar dosjen.

6. Në marrjen e vendimit Këshilli duhet të mbajë në konsideratë veçanërisht ngarkesën në punë të prokurorit, performancën e tij në punë, vështirësitë që mund të shkaktohen në ushtrimin e funksionit, arsyet për ulje në ngarkesë, në qoftë se ka, kualifikimin akademik.

7. Vendimi merret me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve prezent.

8. Në rast se Këshilli brenda një afati trejavor nga marrja e kërkesës nuk shprehet me vendim, nuk njofton të interesuarin, si dhe nuk merr vendimin për zgjatjen e afatit, kërkesa konsiderohet e aprovuar.

9. Në rast se kërkesa nuk përmban të gjitha të dhënat e përmendura në nenin 8, 5 afatet e parashikuara në këtë nen do të konsiderohet se fillojnë nga momenti i plotësimit të këtyre të dhënave dhe paraqitja e dokumentacionit përkatës.

10. Autorizimi është i vlefshme për periudhën kohore të një viti akademik.

Neni 9

Refuzimi i autorizimit

1. Në çdo rast Këshilli refuzon dhënien e autorizimit kur:

a) prokurori është pezulluar nga detyra;

b) prokurori është subjekt i procedimit penal ose disiplinor;

c) prokurori ka një masë disiplinore në fuqi;

d) prokurori ka marrë vlerësim të përgjithshëm “mjaftueshëm” ose “i pamjaftueshëm” në periudhën e fundit të vlerësimit.

2. Autorizimi refuzohet edhe në rast se Këshilli konstaton se angazhimi në këtë veprimtari mund të ndikojë negativisht në ushtrimin e detyrës të prokurorit ose nuk plotësohen kushtet e parashikuara në nenet 6, 7 dhe 8 pika 6, të kësaj rregulloreje.



Neni 10

Revokimi i autorizimit

1. Në rast se pasi është dhënë autorizimi sipas kësaj rregulloreje, por gjithmonë pa mbaruar vlefshmëria e tij, prokurori gjendet në një nga situatat e parashikuara në nenin 9, pika 1, Këshilli bën revokimin e autorizimit në mbledhjen më të afërt nga marrja dijeni.

2. Revokimi bëhet edhe në qoftë se provohet se prokurori është duke ushtruar veprimtarinë jashtë funksionit në kapërcim të kushteve për të cilat është dhënë miratimi. Në këtë rast zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat procedurale të parashikuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Veprimtaria jashtë funksionit jashtë orarit zyrtar

Rregullat e parashikuara në këtë rregullore gjejnë zbatim edhe në rastet e veprimtarisë jashtë funksionit, jashtë orarit zyrtar, me përjashtim të kufizimit në nenin 6, pikat 2 dhe 3, të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Trajnimi në Shkollën e Magjistraturës

1. Pjesëmarrja si ekspert/lehtësues në programin e trajnimit fillestar apo vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, rregullohet sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore në zbatimin e tij.

2. Në çdo rast magjistrati prokuror ka detyrimin të verë në dijeni Këshillin për angazhimin pranë Shkollës të Magjistraturës.

Neni 13

Dispozita të tjera

1. Këshilli bën publike në faqen *web* të tij, listën e magjistratëve prokurorë të autorizuar për veprimtari jashtë funksionit. Lista duhet të përmbajë emrin e prokurorit, të vendin ku ushtron detyrën dhe orët e punës për të cilat ai është autorizuar.

2. Këshilli brenda muajit janar të çdo viti i përcjell Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të

Pasurive dhe të Parandalimit të Konfliktit të Interesit dhe organeve tatimore një raport me shkrim mbi veprimtarinë e ushtruar nga prokurorët në kuadër të kësaj rregulloreje duke përcaktuar pagesën apo shpërblimin e fituar dhe vlerën përkatëse të tregut.

Neni 14

Dispozita kalimtare

1. Autorizimet e dhëna përpara miratimit të kësaj rregulloreje do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në mbarim të afatit/ të vitit akademik për të cilin janë lëshuar.

2. Kontratat e lidhura nga magjistrati në kuadër të veprimtarisë akademike apo trajnuese, përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në mbarimin e vitit akademik.

3. Në çdo rast, prokurorët që kanë filluar një veprimtari sipas pikave të mësipërme të këtij neni, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje i venë në dispozicion Këshillit dokumentacionin provues sipas kërkesave të nenit 5 të kësaj rregulloreje.

4. Kjo rregullore është e detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë prokurorët që ndërmarrin veprimtari jashtë funksionit. moszbatimi i saj përben shkelje të Kodit Etik.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**VENDIM****Nr. 64, datë 15.4.2019****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM TË
PROKURORËVE”**

Në mbështetje të neneve 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 189 dhe 164, pika 8, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe nenit 59, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë



VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

RREGULLORE
PËR CAKTIMIN E PËRKOHSHËM TË
PROKURORËVE

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i parimeve, kriterëve dhe procedurave për caktimin e përkohshëm të prokurorëve në pozicione të përkohshme të krijuara në sistemin e prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 59, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2
Parimet bazë

Procedura e caktimit të përkohshëm kryhet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, objektivitetit, eficiencës dhe transparencës.

Neni 3
Kriteret për caktimin e përkohshëm të
prokurorëve

1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtin prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.

3. Këshilli nuk mund të caktojë përkohësisht një prokuror më shumë se katër herë në të njëjtin pozicion ose në një pozicion tjetër.

4. Gjatë procedurës së përzgjedhjes së prokurorit për caktimin në një pozicion të përkohshëm, Këshilli mban parasysh:

a) përvojën dhe fushën e specializimit të prokurorit;

b) balancimin e nevojave të prokurorisë ku prokurori ushtron funksionin dhe prokurorisë ku ai do caktohet përkohësisht;

c) disponueshmërinë e prokurorit.

Neni 4
Procedura

1. Në rastet kur një prokuror me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, drejtuesi i prokurorisë vë në dijeni Këshillin për këtë situatë.

2. Këshilli vihet në dijeni edhe për rastet e tjera të krijimit të pozicioneve të përkohshme sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Këshilli merr vendim për plotësimin e vendit përkohësisht të lirë me anë të caktimit të përkohshëm.

4. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të paraqesë propozime për kandidatura për caktimin e përkohshëm.

5. Anëtari depoziton propozimin e tij me shkrim te Kryetari i Këshillit, i cili ia përcjell propozimet Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

6. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikon për çdo kandidat të propozuar, faktin nëse ka një masë disiplinore në fuqi, nëse ndaj tij ka filluar procedimi penal si dhe nëse i plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji për atë pozicion, dhe i paraqet Këshillit kandidaturat, së bashku me të dhënat mbi përvojën dhe fushën e specializimit të prokurorit/prokurorëve që propozohen për caktim.

7. Vendimi për caktimin e përkohshëm merret nga Këshilli bazuar në propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

8. Këshilli voton në seancë plenare dhe miraton kandidaturën me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Nëse asnjë nga kandidatët nuk arrin të marrë shumicën e votave, zhvillohet një raund i dytë votimi mes dy



kandidatëve që kanë siguruar më shumë vota në raundin e parë. Nëse votat shpërndahen në mënyrë të barabartë, zhvillohet short për përcaktimin e kandidatit që caktohet në mënyrë të përkohshme në atë pozicion.

Neni 5

Vendimi për caktimin e përkohshëm

1. Vendimi i Këshillit për caktimin e përkohshëm përmban datën e fillimit dhe të mbarimit të caktimit.

2. Vendimi për caktimin e përkohshëm publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Vendimi i komunikohet përkatësisht prokurorisë ku i caktuari ushtron funksionin, prokurorisë ku caktohet përkohësisht, si dhe prokurorit të caktuar përkohësisht.

Neni 6

Mbarimi i caktimit të përkohshëm

1. Caktimi i përkohshëm mbaron me përfundimin e afatit për të cilin është miratuar.

2. Prokurori i caktuar përkohësisht, me përfundimin e afatit të caktimit, kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveç rasteve kur Këshilli merr një vendim tjetër.

Neni 7

Ndryshimi i statusit të pozicionit

1. Pozicioni i plotësuar përkohësisht konsiderohet i lirë në mënyrë të përhershme, në rastet e parashikuara në pikën 5, të nenit 59, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Magjistrati që është caktuar përkohësisht në këtë pozicion njoftohet për ndryshimin e pozicionit nga një pozicion i përkohshëm në të përhershëm.

3. Çdo magjistrat i caktuar përkohësisht në atë prokurori mund të kërkojë që pozicioni i tij të bëhet i përhershëm, me anë të një kërkesë drejtuar Këshillit.

4. Këshilli vendos për ndryshimin e pozicionit të përkohshëm dhe plotësimin e pozicionit në mënyrë të përhershme.

5. Nëse ka disa kërkesa, nga magjistratë me pozicione të përkohshme në atë prokurori, për

vlerësimin e tyre, Këshilli përdor kriteret e transferimit, për aq sa është e mundur.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

URDHËR**Nr. 368, datë 2.5.2019****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Gelardina Prodani, Sekretar i Përgjithshëm.

a) Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe t'i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga znj. Gelardina Prodani, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

b) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



c) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale .

d) Autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës brenda vendit të punës në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

e) Të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale .

f) Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

g) Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Gelardina Prodani, Sekretar i Përgjithshëm, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

4. Urdhri nr. 330, datë 15.4.2019 “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet znj. Gelardina Prodani, Sekretar i Përgjithshëm, dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

VENDIM
Nr. 57, datë 15.4.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS
PËR MIRATIMIN E “NIVELEVE
KUFÏ/PRAGJET PËR KLASIFIKIMIN E
GJENERUESVE TË RINJ ME SISTEMIN,
NË TIPIN A, B, C DHE D, SIPAS
VENDIMIT TË ERE-s NR. 129, DATË
4.6.2018, “MBI MIRATIMIN E KODIT TË
RRJETIT MBI KËRKESAT PËR
LIDHJEN ME RRJETIN
E GJENERUESVE”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 19, germa “e”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 15; nenit 5, pika 3 dhe nenit 10 të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve” (RfG), miratuar me vendimin e ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; parashikimeve të vendimit nr. 2018/03/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.4.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”,

konstatoi se:

- OST sh.a. në vijim të miratimit nga ERE, me vendimin nr. 129, datë 4.6.2018, të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve”, (RfG), me shkresën e protokolluar në ERE nr. 227, datë 18.3.2019, ka përcjellë propozimin për përcaktimin e niveleve kufi/pragjeve maksimale të kapacitetit për modulet gjeneruese të tipit A, B, C dhe D.

- Propozimi vjen në kuadër të detyrimit që përcakton pika 15 e Kodit të Rrjetit për operatorët e sistemit të transmetimit dhe



shpërndarjes, në lidhje me përcaktimin e niveleve kufi/pragjeve për gjeneruesit në konsultim me palët e interesit dhe paraqitjen për miratim në ERE.

- OST sh.a. ka draftuar një dokument i cili pasqyron Kodin RfG, procesin e implementimit dhe statusin aktual të sistemit, rolin dhe faktorët me ndikim në përcaktimin e niveleve kufi/pragjeve, si dhe identifikon e vlerëson opsionet e niveleve kufi/pragjeve që mund të aplikohen në sistemin shqiptar duke i krahasuar edhe me zgjidhjet në vendet e rajonit.

- OSHEE sh.a. ka rekomanduar që centralët mbi 7 mw, të lidhen në rrjetin 110 kV, pasi rrjeti i shpërndarjes që menaxhohet nga OSHEE sh.a., nuk mund të përballojë burime gjeneruese mbi këtë vlerë.

- Në lidhje me komentet e OSHEE sh.a., shoqëria OST sh.a., ka sqaruar se, sikurse përcaktohet në Rregulloren e Komisionit të BE-së 2016/631, 14 prill 2016, “Për krijimin e një kodi rrjeti për kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneratorëve” (transpozuar me vendimin nr. 129, datë 4.6.2019, të Bordit të ERE-s), përcaktimi i niveleve, kufi/pragjeve, nuk është mekanizëm dhe nuk mund të përdoret për të kushtëzuar nivelin e tensionit të pikës së lidhjes së gjeneruesve të rinj në rrjetin e transmetimit apo shpërndarjes.

- Propozimet e OSHEE sh.a. janë reflektuar në draftin final, i cili i është përcjellë ERE-s për miratim nga OST sh.a., e cila në kuadër të konsultimit të këtij drafti me palët e interesit, e ka dërguar atë për opinion edhe pranë MIE-t, AKBN-së, KESH sh.a., Universitetit Politeknik të Tiranës, AREA-së dhe FIAA-së.

- OST sh.a., në paraqitjen e planit të investimeve për vitin 2019, ka parashikuar fuqizime, ndërtime dhe rehabilitime të aseteve të saj në kuadër të përmirësimit të rrjetit të transmetimit.

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, në opinionin mbi draftin e paraqitur nga OST sh.a., fokusohet në evidentimin e përdoruesve aktualë të sistemit, kapacitetit të tyre të instaluar, përmbushjes së kërkesave teknike në lidhje me rregullimin tension/frekuencë, parametrat RAT (Rregullimi Automatik i Tensionit) dhe RASH (Rregullimi Automatik i Shpejtësisë), si dhe ndikimi i sigurisë operationale të sistemit

elektroenergjitik. Fakulteti shprehet edhe për identifikimin e opsionit më të përshtatshëm të niveleve kufi/pragjeve të klasifikimit të gjeneruesve dhe parashtrimin e një opsioni alternativ, duke konsideruar rritjen e sigurisë statike dhe dinamike të sistemit. Parashtrimin e avantazheve të opsionit alternativ të paraqitur nga UPT/FIE/DSEF si për sa i përket sigurisë operative, rritjes së ofertës dhe konkurrencës në tregun e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit për OST sh.a., ndikimin pozitiv në emetimet në atmosferë dhe përgatitjen e sistemit për përballje me injektimin e shtuar nga burimet rinovueshme (fotovoltaike dhe eolike).

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka shprehur në parim dakordësinë e saj me këtë draft, duke kërkuar marrjen në konsideratë edhe të rezultatit të konsultimit me palët e interesit.

- Komentet e përcjella nga UPT/FIE/DSEF, konvergojnë dukshëm me frymën e Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631, 14 prill 2016, “Për krijimin e një kodi rrjeti për kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneratorëve” (transpozuar me vendimin e ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018), si dhe me këndvështrimin e OST sh.a., në njërin nga opsionet e propozuara në dokumentin e draftuar dhe përcjellë në ERE.

- RfG përcakton, katër tipa gjeneruesish, të cilët karakterizohen nga aftësi teknike të ndryshme, të cilat janë të nevojshme dhe të detyrueshme për t'u zbatuar, me qëllim mbështetjen e operatorëve të sistemit në përmbushjen e funksionit të tyre. Rregullorja e Komisionit të BE-së 2016/631, 14 prill 2016, “Për krijimin e një kodi rrjeti për kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneratorëve”, i përdor nivelet kufi/pragjet e gjeneruesve për të aplikuar kërkesat për shkëmbimin e të dhënave nga modulet e reja dhe ekzistuese të gjenerimit të energjisë. Secili nga katër tipat e gjeneruesve parametrizohet nga niveli i tensionit të pikës së lidhjes dhe kapaciteti i instaluar i njësisë në mw. Për secilën zonë sinkrone evropiane të ENTSO-E, RfG ka përcaktuar për secilin tip nivelet kufi/pragjet e kapaciteteve në mw. Gjithashtu, duke qenë se, OST sh.a. është aktori kryesor në këtë proces, RfG përshkruan procesin që duhet të ndjekë secili prej tyre për të përzgjedhur dhe miratuar nivelet kufi/pragjet që do të aplikohen në nivel kombëtar.



- Procesi i klasifikimit të gjeneruesve dhe përcaktimi i nivelit të kufi/pragjeve synon të balancojë nevojën e OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. për të garantuar dhe menaxhuar sisteme të sigurt dhe të fuqishme, kundrejt vendosjes së një niveli proporcional të mbështetjes së detyrueshme të gjeneruesve të lidhur me sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes.

- Opsioni i Mesëm i draftuar nga vetë OST sh.a. siguron një shpërndarje të numrit të centraleve të tipit C dhe D të aftë për të mbështetur operimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit respektivisht me rreth 9% dhe 4%.

- Nga analiza e draftit të përcjellë nga OST sh.a., me kufi/pragjet e tipave A, B, C dhe D, ERE vlerëson se Opsioni më i pranueshëm për t'u zbatuar teknikisht është ai i propozuar nga vetë OST sh.a., pasi pragjet janë relativisht më të

ulëta në krahasim me ato të Universitetit Politeknik të Tiranës, i cili po ashtu në shkresën e tij nr. 61/1, datë 15.2.2019, në seksionin 3, ka sugjeruar si Opsion Alternativ kufi/pragjet e propozuara nga OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”, si vijon:

Tipi A	Niveli i tensioni në pikën e lidhjes $<110\text{kV}$ dhe kapaciteti i moduleve $800\text{W} \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 1\text{MW}$
Tipi B	Niveli i tensioni në pikën e lidhjes $<110\text{kV}$ dhe kapaciteti i moduleve $1\text{MW} \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 10\text{MW}$
Tipi C	Niveli i tensioni në pikën e lidhjes $<110\text{kV}$ dhe kapaciteti i moduleve $10\text{MW} \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 30\text{MW}$
Tipi D	Niveli i tensioni në pikën e lidhjes $\geq 110\text{kV}$ ose kapaciteti i moduleve $P_{Max}^{Kapaciteti} \geq 30\text{MW}$

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 58, datë 15.4.2019

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) SHA DHE FURNIZUESIT

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; nenit 19, pika 2, të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë



Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.4.2019, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi miratimin e disa ndryshime në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 975 prot., datë 17.1.2018, kërkoi shqyrtimin dhe vendimmarrjen në lidhje me disa propozime për ndryshime në këtë rregullore.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 30, datë 9.2.2018, ka vendosur për fillimin e procedurës së shqyrtimit dhe miratimit të këtyre ndryshimeve të propozuara, nga ana e OSHEE sh.a.

- Me shkresën nr. 55/6, datë 12.2.2018, ERE publikoi në shtypin e shkruar për tri ditë me radhë njoftimin për fillimin e procedurës për disa ndryshime në marrëveshjen për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, me qëllim mbledhjen e opinioneve të të gjithë të interesuarve.

- ERE, nëpërmjet shkresës së nr. 206 prot, datë 23.2.2018, ka përcjellë vendimin e sipërpërmendur për marrje mendimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqatës “AAES” dhe shoqatës “FIAA”.

- Në përgjigje të shkresës për marrje mendimi lidhur me fillimin e procedurës për disa ndryshime në marrëveshjen për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, është shprehur vetëm shoqata “AAES” me shkresën nr. 4 prot., datë 8.3.2018 dhe protokolluar në ERE me nr. 206/1, datë 12.3.2018.

- Pas shqyrtimit të qëndrimeve të shoqatës “AAES”, duke konstatuar se ka mosdakortësi në lidhje me disa nga propozimet e me qëllim finalizimin e kësaj praktike pasi të ishin shteruar të gjitha pyetjet e lindura nga palët e dhënë shpjegimet e nevojshme me shkresën nr. 206/2 prot., datë 20.3.2018 ERE njoftoi zhvillimin e një seance

dëgjimore me praninë e OSHEE-së, AK-së dhe AEES-së.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 975/1 prot., datë 3.5.2018, ripërcolli në ERE sugjerimet e përcjella më herët për pika të marrëveshjes të cilat mendon që kanë nevojë të rishikohen

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 79/2 prot., datë 28.5.2018, dërgoi për opinion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqatës “AAES” dhe shoqatës “FIAA” këto propozime shtesë të OSHEE-së në të cilat janë të integruara edhe propozimet për të cilat Bordi i ERE-s ka nisur procedurën e me të cilat palët e interesit ishin njohur edhe më herët.

- Pas përfundimit të afatit të parashikuar, për mbledhjen e komenteve, nuk rezultoi të ketë mbërritur në ERE koment, përveç qëndrimit të Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 144/4 prot., datë 18.6.2018 dhe protokolluar në ERE me nr. 79/3, datë 19.6.2018, i cili bën me dije se nuk ka komente mbi këto ndryshime shtesë të propozuara.

- Në mungesë të opinionit nga palët e interesit, e duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij akti rregullator, me qëllim finalizimin e kësaj praktike në mbrojtje të interesave të të gjitha palëve pjesëmarrëse në të, në datën 8.10.2018 u zhvillua një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e OSHEE sh.a. dhe shoqatës “AAES”.

- Me shkresën nr. 975/3 prot., datë 17.12.2018, OSHEE sh.a. ka përcjellë në ERE variantin përfundimtar të ndryshimeve që kërkon të rishikohen në marrëveshjen për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike.

- Me shkresën nr. 201 prot., datë 4.3.2019, të gjitha palët e interesit janë njohur edhe njëherë me përmbajtjen e ndryshimeve të propozuara së fundmi e të konsideruara nga OSHEE sh.a. si rishikim i propozimeve të depozituara me qëllim fillimin e procedurës.

- Në përfundim të afatit për marrjen e opinionit të palëve të interesit mbi sa bërë me dije dhe mungesë të opinioneve mbi ndryshimet e fundit të bëra me dije, konstatohet se nuk ka asnjë shkak të ligjshëm për të shtyrë mbylljen e procedurave e marrjen e vendimit të Bordit të ERE-s në lidhje me sa propozuar nga OSHEE sh.a.



- Propozimet e OSHEE sh.a., si dhe qëndrimet e palëve të interesit në lidhje me sa propozuar janë shqyrtuar nga grupi i punës dhe është vendosur për pranimin e atyre propozimeve për ndryshime të cilat përveç përputhshmërisë me ligjin janë gjendur edhe në dakordësi e në harmoni me palët e interesit.

- Propozimet e OSHEE sh.a. dhe të dakordësuara me palët e interesit, përmirësojnë termat e përdorur në këtë marrëveshje, lehtësojnë ushtrimin e aktivitetit të OSHEE sh.a. në funksion të zbatimit të marrëveshjes, si dhe nuk pengojnë operimin e kryerjen e objektit të veprimtarisë së furnizuesve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesërisht kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a. për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017 “Për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike”, për ndryshimet si më poshtë:

a) Kudo në marrëveshje, fjala “konsumator fundor” është zëvendësuar me fjalën “klient fundor”;

b) **Neni 8, pika 8.1** ndryshon: në të gjitha rastet e ndërprerjeve sipas kërkesës së OSHEE-së, pavarësisht aplikimit të të drejtave të Furnizuesit, të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje, OSHEE-ja do t’i paguajë Furnizuesit penaltetet automatike të përlogaritura në përputhje me dispozitat përkatëse të “Rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”;

c) **Neni 11, pika 11.2** ndryshon: OSHEE-ja duhet të provojë se ndërprerja ishte e vetmja mënyrë për të garantuar sigurinë në punë të Sistemit të Shpërndarjes dhe se furnizimi i KF-së nuk ishte më i mundur. Në rast se Furnizuesi ka pretendime, do të ndiqen procedurat e përcaktuara në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje. OSHEE-ja, në përputhje me kodet e industrisë, rregullat dhe marrëveshjet, do të bëjë përpjekjet më të mira të mundshme në mënyrë që të përfundojë sa më shpejt kryerjen e punimeve dhe minimizojë shqetësimet/problemet për Furnizuesin. OSHEE-ja do të njoftojë Furnizuesin menjëherë pas marrjes dijeni për ngjarjen e ndërprerjes. OSHEE-ja,

brenda gjashtë ditëve pune, me anë të një akti teknik do të informojë zyrtarisht Furnizuesin në lidhje me rastin e ndërprerjes;

d) **Neni 13, pika 13.2** ndryshon: OSHEE-ja mund të veprojë për të ndërprerë pikën e furnizimit të Konsumatorit Fundor pa njoftuar ose u konsultuar me Furnizuesin në rastet kur ndërprerja është urgjente, ose kur OSHEE-ja ndërpret ndonjë linjë të sipërme private të energjisë elektrike si rezultat i ndalimit të zjarrit ose veprimeve të tjera lehtësuese. Në zbatim të Kodit të Shpërndarjes, pika III.11 “Për sigurinë e furnizimit dhe standardeve të performancës për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, ndërprerja do të bëhet e menjëhershme për të ruajtur sigurinë e jetës së njerëzve, sigurinë e pajisjeve, ndërprerjen e ndërhyrjeve abuzive nga konsumatorët fundor në rrjet.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 59, datë 15.4.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “S G D ENERGJI” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NDËRFUSHAS”, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1125 kw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të



“Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.4.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “S G D Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Shoqëria “S G D Energji”, sh.p.k., me shkresën nr. 250 prot., datë 27.4.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi totale të instaluar 1125 kw.

Aplikimi i shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, dhe “c” “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.5, germat “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Shoqëria “S G D Energji” sh.p.k. ka lidhur kontratën me nr.2728 rep.; nr. 1293/1 kol., datë 6.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Ndërfushas”, me kapacitet prodhues 1125 kw, në rrjedhën e mesme të përroit të Sharrës dhe përroit të Zhavoreve, degë e përroit të Lenës, degë e lumit Mat, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, për një afat 49-vjeçar (dyzetënëntëvjeçar). ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin

ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë eklektike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria) dhe germa “c” (struktura e ndërtimit të shoqërisë). Lista e personelit sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca);

- nenin 9, pika 3 germa “b” (paraqitje e bilancit financiar të tri viteve të fundit); dhe

- nenin 9, pika 4.1.5, germa “a” (miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi totale të instaluar 1125 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 60, datë 15.4.2019

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË
PÛRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA
“ALBGAS” SHA, PREJ 28 LEKË/m³ OSE
2.6457 LEKË/kwh, DERI MË
DATË 31.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të nenit 13, pika 1, nenit 16, pika 2, nenit 17, pika “e” dhe nenit 33, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 15 “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.4.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me shtyrjen e fuqisë juridike së vendimit të Bordit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018 “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 ‘Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2018’”, i ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 235, datë 2.11.2018 “Për një ndryshim në vendimin nr. 196, datë 30.8.2018, “Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s, nr. 120, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të shoqërisë “Albgaz” sh.a.”, vendimin nr. 121, datë 4.6.2018, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shoqërisë “Albgaz” sh.a.”, vendosi që:

1. Shoqëria “Albgaz” sh.a. të depozitojë pranë ERE-s, jo më vonë se data 20.1.2019, miratimet nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Investimeve për vitin 2018 që reflektojnë ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43 prot., datë 21.3.2018, “Argumentime më të detajuara lidhur me projektet”.

2. Shoqëria “Albgaz” sh.a. të depozitojë pranë ERE-s jo më vonë se data 20.1.2019 miratim nga Këshilli Mbikëqyrës, të Planit të Zhvillimit të Rrjetit për periudhën 2018–2027, që reflekton ndryshimet e paraqitura pas shkresës nr. 43,

prot., datë 21.3.2018 “Argumentime më të detajuara lidhur me projektet”.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk ka paraqitur aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit për vitin 2019 në përputhje me metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit për gazin natyror dhe konform përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

- Neni 17, pika “e”, e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, përcakton se:

- “ERE miraton tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2018, si dhe vendimin nr. 179, datë 20.8.2018 “Për një shtesë në vendimin nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2018”, vendosi miratimin e tarifës të transmetimit të gazit natyror prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh për shoqërinë “Albgaz” sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018”.

- Mungesa e vlerës së investimeve për vitin 2019, si komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës dhe që pritet të paraqitet në vitin pasardhës, bën të pamundur llogaritjen e të ardhurave të kërkuara dhe përcaktimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2019.

- Tarifa e aktivitetit të transmetimit është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëria “Albgaz” sh.a., aktivitet ky, që ushtrohet konform ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar. Aksesit në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

- Kushtet të cilat detyruan Bordin e ERE-s për marrjen e vendimit nr. 269, datë 21.12.2018, nuk kanë ndryshuar dhe ndërkohë, shoqëria “Albgaz” sh.a. nuk është shprehur në lidhje me tarifën e transmetimit të gazit natyror, për



periudhën në vijim, pavarësisht kërkesave të sipërcituara në lidhje me këtë çështje.

- Në kontratën e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a., për miratimin e së cilës ERE ka filluar procedurën e miratimit me vendimin nr. 49, datë 27.3.2019, është parashikuar se: çmimi i ofrimit të shërbimit të transmetimit të gazit natyror sipas kësaj kontrate është ai i vendosur në bazë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a., për vitin 2018”, lënë në fuqi me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018, deri më 31 mars 2019, për tarifën e shërbimit të transmetimit është 28 lekë/m³, pa TVSH, ku shoqëria “Albgaz” sh.a., është me cilësinë e transmetuesit të gazit natyror dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a., është me cilësinë e prodhuesit të gazit natyror.

- Në lidhje me këtë përcaktim të kontratës sqarojmë se, pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 269, datë 21.12.2018, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2018, i ndryshuar, siguron që, në rast se tarifa e miratuar për periudhën mbas datës 31 mars 2019 deri më 31 dhjetor 2019 rezulton e ndryshme nga ajo e përkohshme (28 lekë/m³), atëherë efektet e mundshme në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a., do të përditësohen dhe kompensohen sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

- Duke qenë se, çmimi që do të aplikohet për këtë kontratë do të jetë ai që do të miratojë Bordi i ERE-s për vitin 2019, ERE i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 206 prot., datë 7.3.2019, ku i ka kërkuar këtij të fundit paraqitjen sa më shpejtë të të ardhurave të kërkuara për të mundësuar zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërisë “Albgaz” sh.a. për vitin 2019 ose ndjeshmërinë/pritshmërinë e shoqërisë, në lidhje me mjaftueshmërinë e tarifës në fuqi të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018, për të cilën është ende në pritje të përgjigjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a., në vlerën e përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2018, si dhe vendimin nr. 179, datë 20.8.2018 “Për një shtesë në vendimin nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ‘Albgaz’ sh.a. për vitin 2018”, vendosi miratimin e tarifës të transmetimit të gazit natyror prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh për shoqërinë ‘Albgaz’ sh.a., për periudhën 1.1.2018–31.12.2018”.

2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NJOFTIM
Nr. 6551, datë 2.5.2019

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË AKTI NDËRKOMBËTAR

“Traktati Themelues i Komunitetit të Transportit”, në përputhje me nenin 41(2) të tij, pas përfundimit të procedurave ligjore të brendshme nga shtetet nënshkruese të tij, hyn në fuqi në datën 1 maj 2019. Si rrjedhojë, kjo është



data e hyrjes në fuqi e Traktatit edhe për Republikën e Shqipërisë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 91 (415), datë 30.1.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Astrit Maksut Puci, i datëlindjes 9.6.1972 dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetases Dhurata Fatbardh Puci.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 206 (952), datë 25.2.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Lidia Preka, e datëlindjes 2.11.1966 dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të kërkuases Diela Preka.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë